

	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	 <p style="text-align: center;">PRISHTINA</p> <p style="text-align: center; color: blue; font-size: 1.2em;">01-1039</p>
---	--	--

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008 nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr. 110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-100401/20 dt. 24.06.2020, të pronarit Ali Sefa, Fadil Kurteshi dhe Art Construction LLC nga Prishtina, me investitor “Art Construction” LLC nga Prishtina me certifikatë të regjistrimit ARBK 810808066, me përfaqësues Faton Sinani, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, të ndërtesës shumë banesore me afarizëm, me etazhitet B+P+5 e ndërtuar në kuadër të bllokut urban “C9” tërësisë “C” të Planit rregullues “Mati 1”, konkretisht në parcelën nr. 1603-0, Zona Kadastrale Matiçan, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datën 10.03.2021 lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LËSHOHET Certifikata e përdorimit pronarëve Ali Sefa, Fadil Kurteshi dhe Art Construction LLC nga Prishtina, me investitor “Art Construction” LLC nga Prishtina me certifikatë të regjistrimit ARBK 810808066, me përfaqësues Faton Sinani, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-100401/20 dt. 24.06.2020, për përdorimin e ndërtesës shumë banesore me afarizëm, me etazhitet B+P+5, e ndërtuar në kuadër të bllokut urban “C9” tërësisë “C” të Planit rregullues “Mati 1”, konkretisht në parcelën nr. 1603-0, Zona Kadastrale Matiçanm sipas Vendimit 05Nr.351/02-0257360/17 dt. 15.01.2018 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës , .

II. Ndërtesa, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05Nr.351/02-0257360/17 dt. 15.01.2018, dokumentacionit ndërtimor dhe Njoftimin e Inspektimit Final, nga Inspekcioni i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës.

III. Ndërtesa mund të përdoret nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certifikate.

IV. Kjo Certifikatë shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrin kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.

V. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas shtojca 6 e Udhëzimit Administrativ MMPH. Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronarët Ali Sefa, Fadil Kurteshi dhe Art Construction LLC nga Prishtina, me investitor “Art Construction” LLC nga Prishtina me certifikatë të regjistrimit ARBK 810808066, me përfaqësues Faton Sinani, më kërkesën me 05 Nr. 351/04-100401/20 dt. 24.06.2020, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit të ndërtesës shumë banesore me afarizëm, me etazhitet B+P+5, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certifikate.

Paraprakisht Drejtoria e Inspektionit-Sektori i ndërtimit i Komunës së Prishtinës përmes shkresës zyrtare "Njoftim mbi inspektimin final me referencë 09 Nr. 354/02-0089971/18 dt. 15.06.2020, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizmit, Raportin e Inspektimit final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspektionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, investitori ka prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e udhëzimit administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit shtojca 2 dhe 4/a deri 4/f

- Vendimin nr. 05Nr.351/02-0257360/17 dt. 15.01.2018 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës shumë banesore me afarizëm, me etazhitet B+P+5 pronarëve Ali Sefa, Fadil Kurteshi dhe Art Construction LLC nga Prishtina, me investitor "Art Construction" LLC nga Prishtina me certifikatë të regjistrimit ARBK 810808066, me përfaqësues Faton Sinani e ndërtuar në kuadër, të bllokut urban "C9" tërësisë "C" të Planit rregullues "Mati 1", konkretisht në parcelën nr. 1603-0, Zona Kadastrale Matiçan.
- Dispozita urbanistike e objektit me parcelën kadastrale në sistemin Kosovaref01.
- Aktvendimin numër 05 Nr. 351/02-0257360/17 dt. 28.12.2017, mbi caktimin e taksës Administrative për lejen e ndërtimit dhe tarifën për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Dëshmi mbi pagesën e taksës administrative për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Informim mbi caktimin e adresës për objektin me nr. të referencës 05-015/02-139331/19 dt. 17.06.2019, Rr. "Nezir Mujaj".
- Raportin e mbikëqyrjes profesionale për secilën nga fazat e projektit si dhe raportin e udhëheqësit të punishtes, Sevdat Bektashi, IDA. udhëheqës i vend ndërtimit, Sevdat Bektashi, IDA. mbikëqyrës për arkitekturë, Sami Idrizi IND. mbikëqyrës për Strukturë, Astrit Salihu, IDH. mbikëqyrës për Hidro-Instalime, Kushtrim Krasniqi, IDE. Mbikëqyrës për Instalime elektrike, Gazmend Krasniqi, IDM. Mbikëqyrës për Instalime makinerike, Naser Berisha, IDA. mbikëqyrës për instalimet për mbrojtje nga zjarri, Valon Bislimi, gjeodet.
- Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01,
- Protokollin e miratuar për të gjitha fazat e ndërtimit,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve,
- Fotografi gjatë procesit të ndërtimit,
- Fletë pagesat për pagesën e kompensimit,
- Kopjet e diplomave të inxhinierëve mbikëqyrës të objektit,

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Njoftimit mbi Inspektimin Final të ndërtimit të ndërtesës nga Inspektioni me referencë 09 Nr. 354/02-0089971/18 dt. 15.06.2020, dhe pas dorëzimit të dokumentacionit nga ana e investitorit, përmes kërkesës 05 Nr. 391/02-100401/20 dt. 24.06.2020 ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve mbikëqyrës fazave të ndërtesës: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, instalimeve makinerike, mbrojtjes nga zjarri dhe punëve zejtare si dhe matjeve gjeodezike, konstatohet se ndërtesa është realizuar në përputhshmëri të plotë me Ligjin e Ndërtimit Nr. 04/L-110, projektin kryesor, Lejen ndërtimore 05Nr.351/02-0257360/17 dt. 15.01.2018. Po ashtu theksohet se punët janë zhvilluar në harmoni me projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm, mund të përdoret.

Në Njoftimin mbi inspektimit final të lëshuar nga Drejtoria e Inspektionit-Sektorit i Ndërtimit, është konstatuar se të gjitha punimet në objekt janë të përfunduara, dhe se udhëzohet pala që ta vazhdojë procedurat për pajisje me certifikatë të përdorimit. Po ashtu edhe kërkesat që dalin nga Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 27 janë të aprovuara nga ana e Mbikëqyrjes Profesionale të angazhuar nga ana e Poseduesit të Lejes Ndërtimore.

Kërkesat e Vendimit Lejes Ndërtimore janë zbatuar,

Të gjitha mbetjet janë larguar nga vendi i ndërtimit dhe janë dërguar në një vend adekuat për deponimin e mbeturinave,

Masat për kursim të energjisë janë zbatuar.

Kjo drejtori, bazuar në raportet e prezantuara dhe konstatimet e lartcekura, vendosi që ndërtesa shumë banesore me afarizëm, me etazhitet B+P+5, mund të përdoret/shfrytëzohet, gjegjësisht të lëshojë certifikatën e përdorimit për këtë ndërtesë.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MEA-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspektionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-100401/20 DT. 10.03.2021**

Zyrtari:

Berim Osmanaj



U.D. Udhëheqëse e sektorit

Mimoza Berisha Prestreshi



